

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.4595 prot., datë 08.03.2021 i ka kthyer përgjigje, duke e vënë në dijeni se dosja me nr.3513 që i përket z.S.S nuk është procesuar për arsye se ka mungesa në dokumentacion. Gjithashtu, kërkuesja është orientuar për plotësimin e të gjithë dokumentacionit përkatës. Por edhe pasi është plotësuar i gjithë dokumentacioni, ende nuk është bërë i mundur akordimi i kështit të III-të.

Konkretisht, në shkresën nr.4595 prot., datë 08.03.2021 në kthimin e përgjigjes drejtuar zonjës D.S nga institucioni juaj është parashtruar se: *“Në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është autoriteti përgjegjës për shpërndarjen e dëmshpërblimit, të miratuar me vendimin të Këshillit të Ministrave, në mënyrë proporcionale në tetë këste të barabarta, deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.*

Ju informojmë se dosja me nr.3513 që i përket ish të përndjekurit politik z.S.S miratuar me VKM nr.1259, datë 23.12.2009, është publikuar në datën 15.02.2021, në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; www.financa.gov.al, si dosje në radhë për të përfituar kështin e tretë të dëmshpërblimit financiar takues. Për sa i përket pagesës së kështit të tretë për dosjen nr.3513, akoma nuk është procesuar, sepse ka mungesa në dokumentacion për të gjithë trashëgimtarët përfitues.

Dokumentacioni që duhet të plotësohet është: ID kartë identiteti të vlefshëm (fotokopje) ose fotokopje pasaporte për të gjithë trashëgimtarët përfitues, çertifikatën e vdekjes dhe çertifikatën e trungut familjar të z.Z.S dhe vërtetimin e numrit të llogarisë bankare të përditësuar të znj.R.Z të cilën e kanë autorizuar më prokurë të posaçme të gjithë trashëgimtarët për të tërhequr dëmshpërblimin financiar.”

Znj.D.S në ankesën e saj parashtron se dokumentacioni i kërkuar nga ana juaj është plotësuar, duke bashkëlidhur kështu edhe një kopje të tij në ankesën e paraqitur në institucionin tonë.

Por nga Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve edhe pas vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, nuk është proceduar me dhënien e kështit të tretë, duke sjellë kështu pengesa të panevojshme.

Në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, si dhe VKM-së nr.419, datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve*

dhe skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka çelur këstin e radhës për kategorinë e trashëgimtarëve (këstin e tretë) në datë 22.10.2018.

Bazuar në udhëzimin nr.5, datë 15.04.2016, Drejtoria e Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, kryen shpërndarjen e dëmshpërblimit të këstit të radhës, duke ndjekur radhën e pagesës së këstit të parë.

Ligji nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij përcakton shprehimisht:

“Struktura përgjegjëse për pagesën e dëmshpërblimeve të ish të dënuarve politikë në Ministrinë e Financave publikon, në mënyrë periodike, në faqen zyrtare, listat e dosjeve të gatshme për pagesë dhe bën njoftimin për të gjitha subjektet përfituese, pjesë e listës, nëpërmjet shërbimit postar, njoftimit me mjete të komunikimit elektronik (e-mail) dhe medias publike.

Brenda një afati 3-mujor nga data e publikimit të listës, të gjithë ish të përndjekurit, të cilët janë pjesë e saj, duhet të dorëzojnë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dokumentet e parashikuara në aktet nënligjore që janë nxjerrë në zbatim të ligjit.

Kur një ish i dënuar politik ose trashëgimtari /trashëgimtarët e ish të dënuarit politik nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të parashikuar në paragrafin e mësipërm, ai/ajo njoftohet lidhur me përfundimin e këtij afati dhe i jepet një afat shtesë deri në 30 ditë. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk dorëzohet edhe pas kalimit të afatit shtesë (30 ditë), pagesa i kalon personave që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshme për pagesë.

Kur një ish i dënuar politik ose trashëgimtari /trashëgimtarët e ish të dënuarit politik refuzon të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të parashikuara si më sipër, forma e refuzimit duhet të jetë me shkrim. Edhe në këtë rast, pagesa i kalon personave që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshme për pagesë.

Personat, të cilët nuk dëmshpërblehen, për shkak të mosplotësimit të dokumenteve, gëzojnë të drejtën për të marrë këstin e kësaj pagese në fazën tjetër, por jo më vonë se tre vjet pas publikimit të emrit për herë të parë në faqen zyrtare. Me kalimin e kësaj periudhe (3 vjet), personi që nuk ka

plotësuar dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, humbet të drejtën e dëmshpërblimit.”

Në përmbajtjen e këtij neni përcaktohen procedurat që duhen ndjekur si nga ana e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve, po ashtu edhe nga ish i dënuari apo trashëgimtarët e tij, me qëllim përfitimin e kësteve, si dhe njëkohësisht moshumbjen e të drejtës së tyre ligjore. Nga ana tjetër, duhet mbajtur në konsideratë se një pjesë e të dënuarve dhe trashëgimtarëve të tyre janë në moshë tepër të thyer, si dhe jetojnë në zona rurale, ku nuk kanë mundësi reale për të marrë informacionin e duhur për afatin përkatës dhe dokumentacionin e nevojshëm që duhet të paraqesin për tërheqjen e dëmshpërblimit.

Dëshirojmë të theksojmë faktin se institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar vëmendje të veçantë trajtimit me prioritet të rasteve për përfitimin e dëmshpërblimit për ish të dënuarit politikë dhe trashëgimtarët e tyre. Trajtimi i kësaj çështjeje delikate ka qënë dhe vijon të jetë ndër vite objekt i fushës së veprimtarisë së Seksionit të Çështjeve të Veçanta, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Asnjëherë nuk duhet harruar se, edhe pse kanë kaluar 30 vjet nga shembja e sistemit komunist në Shqipëri, shoqëria shqiptare është ende e ndjeshme ndaj kësaj periudhe të errët në historinë e saj. Regjimi komunist për gati gjysmë shekulli ka shkaktuar një numër të madh të viktimave në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe në shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar.

Duke nisur nga viti 1991, vit në të cilin u miratua ligji nr.7514, datë 30.09.1991, i ndryshuar, *"Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë"*, rehabilitimi i ish-të përndjekurve politikë duhet të kishte përfunduar tashmë, por për fat të keq kjo shtresë vijon të mbetet e margjinalizuar dhe problem thelbësor i shoqërisë shqiptare.

Në ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 *"Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist"* ekziston detyrimi ligjor dhe moral i shtetit për zbatimin e ligjit e të drejtën për kompensim dhe fillimisht ligji parashikonte se procesi i kompensimit do të plotësohej në fund të vitit 1994. Po ashtu, ligji garantonte lehtësitë dhe përparësitë për kërkesat individuale dhe kolektive në fushat e mëposhtme ekonomike, financiare dhe veprimtaritë sociale: në fushën e privatizimit të pronës shtetërore; dhënies së kredive; ndërtimit dhe strehimit; turizmit arsimimit

dhe kualifikimit punësimit brenda dhe jashtë vendit; përmbushjes së programeve të ndryshme ekonomike dhe sociale kombëtare dhe ndërkombëtare; në fushën e shëndetit publik.

Pavarësisht se trajtimi i dëmshpërblimit dhe kompensimit pasuror të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, fillimisht buron nga ligji 7514, dt. 30.09.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, i ndryshuar, saktësohet dhe rregullohet në mënyrë më të plotë në ligjin *“Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”*, ku përcaktohet kuptimi i kompensimit pasuror të këtyre personave si një shpërblim i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim rroge, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t'i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij kur ai ka vdekur, pa kthim, në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve, duke pasur si qëllim kryesor krijimin e kushteve dhe të mundësive për një integrim sa më të shpejtë të tij dhe të familjes së tij në jetën normale ekonomiko-shoqërore të vendit tonë.

Masat për dëmshpërblimin material përbëjnë veprime të cilat shpesh kuptohen në mënyrë jo të qartë. Rehabilitimi i referohet procesit të rikthimit të një personi në pozitën (personale, profesionale, etj.) që ka patur përpara fillimit të regjimit represiv. Ndërsa, dëmshpërblimi i referohet masave që ofrojnë kompensime të cilat zakonisht marrin formën e paketave të përfitimeve, zhdëmtimeve dhe pagesave të veçanta.

Duke krahasuar dhe analizuar realizimin e masave të përcaktuara në kuadrin ligjor, shpesh nga neglizhenca në hartimin dhe mosnxjerrja në kohë e akteve nënligjore nga organet shtetërore, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet e mësipërme, ish-të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, nuk kanë përfituar plotësisht dhe në kohë nga zbatueshmëria e plotë e kuadrin ligjor dhe për rrjedhojë janë krijuar pasoja serioze në rehabilitimin e tyre. Nga institucionet shtetërore përgjegjëse, jo vetëm që nuk janë realizuar detyrimet ligjore ndaj shtresës së ish-të dënuarve, por nuk as një afat apo datë të saktë se kur do të mbarojë procesi i plotë i dëmshpërblimit, duke shtyrë kështu për një periudhë të pacaktuar e të tejzgjatur rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë.

Në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, në zbatim të të cilit janë nxjerrë edhe aktet nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të komunizmit.

Përqindja e planifikuar çdo vit për dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë rezulton në nivel shumë të ulët nga të ardhurat e planifikuara në buxhet. Pra, ky proces i dëmshpërblimit të ish-të përndjekurve politikë, vazhdon të zvarritet në kohë, duke mos u realizuar brenda afateve të arsyeshme.

Iniciativat e ndërmarra disa herë nga ekzekutivi me qëllim ndryshimin e procedurave, e kanë ndërlikuar disa herë procesin dhe përsëri akoma nuk ka një afat përfundimtar të plotësimit të detyrimit të shoqërisë shqiptare për dhënien e dëmshpërblimit për ish-të dënuarit e të përndjekurit dhe trashëgimtarët e tyre. Gjendja sociale në të cilën gjenden ish- të përndjekurit sot nuk është një gjendje për t'u marrë si model, por një gjendje varfërie.

Vlen të përmendim miratimin e një sërë aktesh të rëndësishme ndërkombëtare në këtë fushë, si Rezoluta nr.1096 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (KE) “Për masat për të çrrënjësuar trashëgiminë e sistemeve totalitare komuniste”, në vitin 1996¹: Deklarata e Pragës *"Mbi ndërgjegjen evropiane dhe komunizmin"* (2008) që përcaktonte angazhimin për të dënuar krimet e komunizmit, sipas praktikës së Gjyqit të Nyrenbergut, si krime kundër njerëzimit; Dëgjesa Publike Evropiane mbi *"Krimet e Kryera nga Regjimet Totalitare"* (2008) dhe të Asamblesë Parlamentare të KE mbi *"Domosdoshmërinë për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste"* (2006) etj.

Përmes këtyre rezolutave, Këshilli i Evropës u kërkonte qeverive postkomuniste të distancoheshin qartësisht nga krimet e regjimeve komuniste totalitare dhe t'i dënonin ato pa asnjë ambiguitet. Këto dokumente kanë qenë të njohura edhe për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, i cili në tetor të vitit 2006, miratoi Rezolutën e vetme në historinë e tranzicionit shqiptar mbi dënimin e krimet komunist, në tekstin e së cilës reflektohen *parimet se njohja dhe denoncimi i krimeve të diktaturës komuniste i shërbejnë shmangies së përsëritjes së krimeve të ngjashme në të ardhmen, duke theksuar domosdoshmërinë e ndëshkimit të krimeve të kryera dhe rivlerësimin real të historisë si një faktor vendimtar në edukimin e brezave të rinj.*

Pavarësisht kësaj, Rezoluta e 30 tetorit 2006 është lënë tërësisht në harresë, pa lënë gjurmë në politikën dhe kujtesën e opinionit publik, duke na treguar se ballafaqimi me të shkuarën nuk ka qenë dhe nuk është prioritet serioz i politikës sonë.

¹ “Reziqet e një procesi tranzicioni të dështuar janë të shumta. Në rastin më të mirë në vend të demokracisë do të mbretërojë oligarkia, në vend të ligjit, korrupsioni dhe në vend të të drejtave të njeriut krimi i organizuar”.

Ka qenë një interes i vazhdueshëm besoj i gjithë shoqërisë shqiptare pas viteve '90-të për të pasur një trajtim më të hollësishëm të kalvarit komunist dhe sistemit në të cilin shqiptarët jetuan për një kohë të gjatë.

Shteti shqiptar përmes rivendosjes së një shoqërie të lirë dhe demokratike, ka marrë përsipër kundrejt shtetasve të tij angazhimin për krijimin e një sistemi ligjor në mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, ku shtetasve shqiptarë t'u jepet garancia e ushtrimit të këtyre të drejtave.

Por, këto të drejta duhet të njihen dhe efektivisht të realizohen nga shteti, brenda një afati të arsyeshëm, për të bërë të mundur përfitimin, në rastin konkret të dëmshpërblimeve për shtresën e ish të përndjekurve politikë.

Sa më sipër, edhe në rastin objekt të ankesës së znj.D.S lind si domosdoshmëri ndërgjegjësimi dhe rritja e përgjegjësisë së strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për rishikimin e dokumentacionit të depozituar nga trashëgimtarët bazuar mbi përgjigjen zyrtare të ministrisë dhe njoftimin në kohë reale të tyre. Nga përgjigjet e ardhura në institucionin e Avokatit të Popullit është vënë re, në disa raste, përpjekja e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshpërblimeve për dhënien përparësi të paragrafit të fundit të nenit 14 ku përcaktohet: *“Personat, të cilët nuk dëmshpërblehen, për shkak të mosplotësimit të dokumenteve, gëzojnë të drejtën për të marrë këstin e kësaj pagese në fazën tjetër, por jo më vonë se tre vjet pas publikimit të emrit për herë të parë në faqen zyrtare. Me kalimin e kësaj periudhe (3 vjet), personi që nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, humbet të drejtën e dëmshpërblimit.”*

Sjellim në vëmendje se gjatë trajtimit të këtyre rasteve nga ana juaj, duhet vlerësuar situata dhe vështirësitë e shkaktuara nga pandemia globale për shkak të virusit Covid-19, me të cilat u përballën të gjitha shoqëritë e në mënyrë të veçantë shtetasit shqiptarë. Pezullimi i veprimtarisë së organeve të ndryshme shtetërore në periudha të caktuara, mungesa e aksesit në informacion, vështirësitë në infrastrukturë etj, për arsye të rrethanave në të cilat kanë qenë qytetarët të detyruar të jetojnë për shkak të masave të kufizuara, patjetër që kanë ndikuar tek ata në përditësimin e dokumentacionit dhe tejkalimin e afateve për depozitimin e tij.

Nga ana tjetër, mendojmë se nuk duhet humbur dëshira e mirë institucionale për të zbatuar dispozitat ligjore në mënyrën më objektive dhe efektive të mundshme në favor të qytetarëve.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për rishikimin me përparësi të dosjes nr.3513 dhe dokumentacionit të depozituar së fundmi, me qëllim akordimin e kështit të tretë të dëmshpërblimit për trashëgimtarët e z. S.S brenda vitit 2021, sipas listës së miratuar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi